

REPublika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Fushë-Kosovës - Opština Kosovo Polje
Drejtoria e Administratës - Direkcija za Administraciju

Nr.faq/Br.str. 14

Datë/Datum 16. 02. 2021

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Drejtoria e Administratës
Shërbimi për Kuvend dhe Komitete

RAPORTI I PUNËS PËR FUNKSIONIMIN E KUVENDIT TË
KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS PËR PERUDHËN
JANAR/DHJETOR 2020

Shkurt 2021

Përmbajtja e raportit.....	2
Hyrja.....	3
Struktura e raportit.....	3
Qëllimi i raportit.....	3
Puna, aktivitetet dhe mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe	
Kuvendit të Komunës.....	4
Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës.....	4
Konkluzionet dhe Rekomandimet.....	9

Hyrje

Raporti i Punës për Funksionimin dhe aktivitetet e Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë e Financa, për periudhën Janar/Dhjetor të vitit 2020 është i bazuar në dispozitat dhe detyrimet që dalin për Legjislativin e Komunës, si organi më i lartë i Komunës nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjet Sektoriale, Udhëzimet Administrative, Statuti i Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012 dhe Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës Nr. 62, të datës 16.05.2013, për realizimin e punëve dhe detyrat e punës së Legjislativit të Komunës.

Në muajin mars 2020 Kuvendi i Komunës, ka aprovuar vendimin për menaxhimin e pandemisë shumë të mjetëve financiare prej: 404,000.00€ dhe në muajin shtator shumë të mjetëve financiare prej 669,140.00€ për shëndetësi dhe përkrahjen e subjekteve afariste.

Kuvendi i Komunës, mbështetur në kompetencat dhe përgjegjësitë e tij, ka miratuar: Kornizën Afatmesme Buxhetore, Buxhetin e Komunës, Raportin Përfundimtar Vjetor Financiar dhe Raportin Financiar gjashtëmuor.

Struktura e raportit

Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës synon të bëjë një vlerësim për progresin e arritur në përmbushjen e obligimeve ligjore, zbatimin e punëve dhe aktiviteteve, mbështetur në kompetencat e bazuara me ligj si dhe nivelin e përmbushjes së përgjegjësisë që lidhen me realizimin e kërkesave të ekzekutivit si dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve të komunës.

Struktura e raportit përfshin:

- Funksionimin e Kuvendit të Komunës;
- Funksionimin e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete;
- Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës;
- Konkluzionet dhe rekomandimet.

Raporti përfshin periudhën Janar/Dhjetor 2020. Raporti bazohet në të dhënat e mbledhura nga ekstraktet e procesverbaleve dhe aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës. Raporti shërben për nxjerrjen e një pasqyre dhe konkluzioneve më të hollësishme për funksionimin e Kuvendit të Komunës dhe hapave të cilët duhet të ndërmerren për përmirësime në të ardhmen.

Qëllimi i raportit

Raporti ka për qëllim informimin e drejtë dhe objektiv të qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, për mënyrën e funksionimit të Kuvendit të Komunës dhe mekanizmave tjerë përcjellës. Raporti pasqyron punën dhe aktivitetet e të zgjedhurve në mbrojtjen e interesave të qytetarëve si dhe shërben si mjet adekuat për rritjen e transparencës së organit më të lartë të komunës, i cili i ka

dy funksione kryesore: 1. Funksionin vendimmarrës në shpërndarjen e buxhetit dhe 2. Funksionin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të shpenzimeve.

Puna, aktivitetet dhe mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës

1. Komiteti për Politikë e Financa, si trup profesional i Kuvendit të Komunës, ka për detyrë shqyrtimin e politikave komunale dhe orientimeve strategjike të Komunës, shqyrtimin e aktiviteteve financiare të Komunës, Planin Vjetor të prokurimit publik, Planin Vjetor të auditimit të brendshëm dhe çështje tjera për të cilat jep rekomandime dhe nxjerr përfundime e konkluzione profesionale se si të veprohet në orientimin e politikave programore për zhvillimin ekonomik lokal, rregullimin hapësinor dhe territorial, zhvillimin, rregullimin dhe strukturimin e administratës, arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, infrastrukturës, mjedisit, bujqësisë, e fushave tjera.
2. Komiteti për Komunitete, si trup profesional i Kuvendit të Komunës, është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Po ashtu, gjatë punës së tij, Komiteti për Komunitete, jep rekomandime për Kuvendin e Komunës lidhur me buxhetin, politikat programore për zhvillimin ekonomik lokal, zhvillimin e administratës, arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, infrastrukturës, mjedisit, bujqësisë, e fushave tjera.
3. Kuvendi i Komunës, si organ më lartë i Komunës dhe organ përfaqësues për subjektet politike, të cilat i përfaqësojnë qytetarët e Komunës dhe e kanë për obligim t'i mbrojnë interesat e tyre. Kuvendi i Komunës, bazuar në kompetencat e tij, propozimet e Ekzekutivit të Komunës, rekomandimet e dy Komiteteve të Përhershme: Komiteti për Politikë e Financa dhe Komiteti për Komunitete, merr vendime për buxhetin dhe çështje tjera financiare, miraton aktet normative nga fusha e veprimtarisë së institucioneve lokale të pushtetit, miraton planet zhvillimore dhe rregullative, bën emërtimin e rrugëve e shesheve në territorin e Komunës dhe vendosë për shumë çështje tjera me interes lokal.

Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës

Janar 2020

1. Vendim për lejimin e shpenzimit të mjeteve financiare në shumë prej 324,000.00€, prej 'Kodit të bashkëfinancimit, kodit të participimit, subvencioneve dhe transfereve duke e përfshirë edhe mbetjen e mjeteve financiare në shumën prej 62,174.86€, nga participimi i fermerëve në vitin 2019, për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2020.
2. Vendim për refuzimin e propozimit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, për themelimin e Komisionit për mbikëqyrjen e shpërndarjes së subvencioneve në bujqësi për fermerët dhe ekonomitë familjare në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2020.

3. Vendim për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës me dokumentacion personal të identifikimit, për vitin 2020 në shumë të mjeteve financiare prej 195.00€, nga buxheti i komunës për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.
4. Vendim për shtyerjen e shqyrtimit të kërkesës për shfuqizimin e vendimit Nr.151, i datës 30.07.2019, deri në miratimin përfundimtar të Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës, e paraparë për shqyrtim dhe miratim në muajin shkurt 2020.
5. Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 200, të datës 13.12.2019, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-1279/3, të datës 27.12.2019, lidhur me marrëveshjen për kompensimin e pronarëve: Naim Enver Nuredini, Shaban Hamit Berisha, Skender Mehdi Maliqi, për pronat e marra për realizimin e interesit publik, 'Projektit për asfaltimin e rrugës', 'Xhamia' në fshatin Sllatinë e Madhe.
6. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 05, të datës 16.01.2020 për emërimin e z. Suhat Ademi i lindur më datë 24.02.1975 me vendbanim në Fushë-Kosovë, përfaqësues nga subjekti politikë Partia Liberale Egjiptiane, në pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, prej datës 29.01.2020 e deri në përfundimin e mandatit zgjedhor 2017-2021.
7. Vendim për ndryshimin e vendimit Nr. 63, të datës 06.04.2018, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, lidhur me përbërjen e Komitetit për Komunitete dhe zëvendësimin e përfaqësueses së subjektit politikë të Partia Liberale Egjiptiane znj. Emine Murtezi, me anëtarin e ri z. Bashkim Krasniqi.
8. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 26, të datës 16.01.2020 për lirimin e bizneseve nga pagesa e taksës komunale për vitin 2020 për të gjitha subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike dhe biznese në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në funksion të krijimit të lehtësimeve për bizneset ekzistuese dhe avantazhe për hapjen e bizneseve të reja dhe gjenerim të punësimit.

Shkurt 2020

1. Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 151, të datës 30.07.2019, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-860/6, të datës 16.10.2019.
2. Vendim për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2019, në shumën prej 370,549.56€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike të mallrave e shërbimeve, subvencioneve e transfereve dhe investime kapitale nëpër kodet e programeve, nënprogrameve dhe projekteve.
3. Vendim për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2018 dhe 2019, në vitin fiskal 2020 në shumë të përgjithshme prej 2,549,524.31€, sipas propozimit me dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 108, të datës 21.01.2020.
4. Vendim për miratimin e propozimit për shpalljen e lokalitetit Boshtres 'Forysthia Europaea' në zonën e Goleshit në fshatin Harilaç monument i mbrojtur i natyrës.
5. Vendim për miratimin e Propozimit Nr. 59, të datës 11.02.2020 për vazhdimin e taksave administrative të vitit 2019 për zbatim edhe në vitin 2020, caktimin e taksës administrative

për leje të ndërtimit, leje të rrënimt dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2020.

6. Vendim për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe harmonizimin e tij gjendjen në teren.
7. Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028.

Mars 2020

1. Vendim për lejimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 404,000.00€, për vazhdimin e masave parandaluese dhe masave tjera shtesë të nevojshme nga Shtabi Emërgjent i Komunës së Fushë-Kosovës për parandalimin e përhapjes së sëmundjes ngjitëse Coronavirus-it COVID - 19.
2. Vendim për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-dhjetor të vitit të 2020, në shumë të përgjithshme prej 11,645,281.00€.

Qershor 2020

1. Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Çerdhes për Fëmijë, në oborrin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë, në Ngatrën Kadastrale me Nr. P-72514036-00792-1, sipas certifikatës së pronës të datës 14.05.2020 në vendin e quajtur 'Selo igralishte' me sipërfaqe $S=13936m^2$.
2. Vendim për aprovimin në parim, të Projekt-Rregullores për organizimin e punës në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët dhe Shkollën të Mesme të Lartë, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës dhe kalimin e saj në procedurën e diskutimit publik.
3. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 15, të datës 22.01.2020, për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të ngatrës kadastrale Nr. P-72514009-00741-1, me sipërfaqe $S=3993m^2$, sipas certifikatës së pronës me Nr. 14-942-40972, të datës 30.12.2019, arë e klasës së pestë, pronë private me posedim individual në vendin e quajtur 'Djak Njive' për palën Selatin Potera në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe.
4. Vendim për dhënien e 'Pëlqimit' për vazhdimin dhe zhvillimin e aktiviteteve biznesore për subjektin afarist, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuara 'Kosmonte Foods', në Ngatrën Kadastrale me Nr. 22-3, në Zonën Kadastrale Harilaç, në vendin e quajtur 'Shume pod Golesh' në sipërfaqe prej $S=43,538 m^2$, me kulturë mal i klasës së dytë, në zonën e destinuar për ngritjes së objektit montazh 'Frigorifer me objektet dhe ambientin përcjelles për ruajtjen dhe kujdesin e gjërave të përkohshme ushqimore me shumicë', duke e ruajtur zonën pyjore dhe ambientin e rrethinës.
5. Vendim për dhënien e 'Pëlqimit' për investime kapitale për zgjerimin e biznesit në sektorin e bujqësisë për subjektin afarist, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuara 'Kosmonte Foods', sipas 'Planit mikrourban të zonës industriale Harilaç'.
6. Vendim për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon: Sabit Bullatovci - Përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar; Ilir Hasani - Përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar; Arjeta Jashari - Përfaqësuese e

Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare; Durim Hajra - Përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar; Arjana Zogiani - Përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar/e; Migjen Kolshi - Përfaqësuesi i Iniciativës Qytetare të Fushë-Kosovës, anëtar; Mehdi Lahu - Përfaqësues i Partisë Social Demokrate, anëtar; Hysni Hasani - Përfaqësues i Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës, anëtar; Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, anëtar; Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë për Kuvend dhe Komitete, anëtar dhe Maliq Thaçi - Përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar.

7. Vendim për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 3,000.00€, për pagesën e pesë punëtorëve vullnetarë në shëndetësi që kanë punuar dhe shërbyerë në parandalimin e Coronavirus-it COVID-19, në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, për dy muaj me nga 300.00€ për secilin muaj kalendarik.
8. Vendim për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon: për vitin 2021 buxheti i komunës është në shumë prej: 11,263,819.00€; për vitin 2022 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,555,971.00€ dhe për vitin 2023 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,852,415.00€.

Korrik 2020

1. Për shfuqizimin e vendimit Nr. 68, të datës 10.06.2020, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-412/11, të datës 17.07.2020, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes për Fëmijë në Fushë-Kosovë.
2. Për plotësimin e vendimit Nr. 50, të datës 02.03.2020 për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028.
3. Për aprovimin në parim të Propozimit për ndryshimin - plotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik.
4. Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës së Sporteve, në vendin të pishat në fshatin Sllatinë e Vogël, në ngastrën kadastrale Nr. 00443-1 me sipërfaqe prej: S=04.53.93ha, në Zonën Kadastrale Sllatinë e Vogël, sipas situacionit të përgatitur gjeodezik dhe grafikë për ndërtimin e objektit dhe hapësirën e lirë.
5. Për aprovimin e Propozimit Nr. 578, të datës 20.07.2020, për shfrytëzimin e mjeteve financiare të mësimi joformal.

Gusht 2020

1. Për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave Nr. 01/1157, të datës 10.08.2020, të cilat ridestinohen dhe shpërndahen për shpenzim nga kategoria ekonomike paga dhe shtesa e planifikuar për vitin 2020, në kategoritë tjera ekonomike për menaxhimin e situatës emergjente në shëndetësi, ekonomi dhe plotësimin e prioritetëve dhe nevojave tjera komunale në shumë prej: 745,000.00€.

Shtator 2020

1. Për shfuqizimin e vendimit Nr. 111, të datës 20.08.2020, sipas shkresës së Divizionit për Buxhetet e Komunave të Ministrisë së Financave të datës 21.08.2020, për lejimin e destinimit dhe shpërndarjen e mjeteve financiare në buxhetin e vitit 2020 sipas shkresës së Nr. 01/1157, të datës 10.08.2020.
2. Për lejimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave Nr. 01/1157, të datës 10.08.2020, të cilat ridestinohen dhe shpërndahen për shpenzim nga kategoria ekonomike paga dhe shtesa e planifikuar për vitin 2020, në kategoritë tjera ekonomike për menaxhimin e situatës emergjente në shëndetësi, ekonomi dhe plotësimin e prioritetëve dhe nevojave tjera komunale në shumë prej: 669,140.00€
3. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2021, në shumë të përgjithshme prej 10,992,686.00€.
4. Për shpalljen nën mbrojtje Lokaliteti i Boshtres 'Forysthia Europea' në zonën e Goleshit në fshatin Harilaç të Fushë-Kosovës, në kategorinë Monument i Natyrës, në tekstin e mëtejme: Monument i Natyrës.
5. Për fillimin e procedurës për hartimin dhe harmonizimin e Planit Zhvillimor Komunal të Fushë-Kosovës
6. Për lejimin e fillimit të procedurës për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Fushë-Kosovës.

Tetor 2020

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-qershor të vitit të 2020, në shumë të përgjithshme prej 4,403,041.39€.
2. Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021

Dhjetor 2020

1. Për aprovimin në parim për diskutim publik të Projekt-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Për aprovimin në parim për diskutim publik të Propozimit Nr. 472, të datës 04.12.2020, për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënimin dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë për vitin 2021.
3. Për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Fushë-Kosovës.
4. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e Krijuesit të vitit 2020.
5. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e Sportistëve të vitit 2020.
6. Për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për vitin 2021.
7. Për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 100.00€, ndihmë për çdo qytetarë të prekur me sëmundjen infektive të pandemisë së Coronavirusit Covid - 19 me testimin RT-PCR, nga buxheti i komunës sipas programeve nëpër Drejtoritë e Komunës.

Është konfirmuar për zbatim: Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2020 (sqarim e miratuar me datën 26.12.2019, e publikuar ne ueb-faqe janar 2020, Rregullorja për Transportin Rrugor në Komunën e Fushë-Kosovës, Plani Komunal për Ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar për vitet 2020-2022, Ndryshim-plotësim të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Komunën e Fushë-Kosovës Nr. 140, të datës 29.09.2017.

Komiteti për Politikë e Financa ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje. Kuvendi i Komunës ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje, prej tyre 10 të rregullta dhe 2 të jashtëzakonshme, janë marrë gjithsej 46 vendime.

Konkluzionet dhe rekomandimet

Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, për të gjitha pikat e rendit të ditës që janë shqyrtuar ka patur debate të hapura dhe përmbajtjesore para marrjes së vendimeve. Vendimet e marra nga Kuvendi i Kumunës dhe ekstraktet e procesverbaleve janë të publikuara në ueb-faqe. Lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, janë dhënë përgjigje gojore për një pjesë të tyre nga Drejtorët e Drejtorive të Komunës dhe Nënkryetari i Komunës.

Ekzekutivi i Komunës ka informuar lidhur me menaxhimin e pandemisë së Coronavirusit Covid - 19 në Kuvendin e Komunës, katër herë, dyherë në muajin qershor, shtatoir dhe dhjetor.

Me respekt!

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

